



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7805 Prot.

Roskovec, më 21, 10 2024

V E N D I M

NR 61 .DATË 30.09 .2024

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË RISHIKUAR TË PBA 2025-2027”

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqverisjen Vendore” i ndryshuar, në nenin 38 të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” të ndryshuar; , ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin Nr.23 datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” , Udhëzimit plotësues Nr.8 datë 05.07.2024 “Për përgatitjen e PBA vendor 2025-2027”; si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria Ekonomike; Këshilli i Bashkisë,

- **VENDOSI:**

1. Të miratojë dokumentin e rishikuar për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Roskovec dhe 4 njësitë shpenzuese në vartësi , sipas tabelave bashkëlidhur siç dhe janë ngarkuar në SMFV:
 - Raporti PBA1: Tavanet Përfundimtare të PBA
 - Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
 - Raporti:PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
 - Raporti: PBA4 - Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)
 - Raporti: PBA5 - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - Raporti: PBA6 - Deklarata së Politikës së Programit

- Raporti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit
 - Raporti: PBA8 - Projektet e Investimeve
 - Raporti: PBA9 - Informacion mbi Programin
 - Relacion shtojca 2 pjesë e dokumentit të rishikuar të PBA
2. Ngarkohen Ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2025-2027 sipas këtij dokumenti .
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

